



Breaking News:

Rinas/Goditet një tjetër rast i tentativës për kalim të paligjshëm të kufirit, me dokumente të falsifikuara



18/12/2025

Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Game Over 2”

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Game Over 2”.

Zbulohet në Ndroq, një lokal ku organizohej veprimtaria e paligjshme e lojërave të fatit.

Vihen në pranga 2 shtetas që u kapën në flagrancë në lokal.

Sekuestrohen 5 celularë që përdreshin për lojëra fati, një sasi lënde e dyshuar narkotike Kokainë, një shumë parash dhe 1 armë sportive.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, në bashkëpunim me strukturat për Hetimin e Krimeve Kibernetike, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërive, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, kanë organizuar kontrolle në lokale dhe ambiente të ndryshme ku dyshohet se zhvillohen lojëra fati të paligjshme dhe, si rezultat, kanë goditur 1 rast të kësaj veprimtarie.

Në kuadër të operacionit policor të koduar “Game Over 2”, u arrestuan shtetasit:

E. Ç., 34 vjeç dhe I. T., 31 vjeç, të dy banues në Ndroq.

Këta shtetas u kapën në flagrancë në një lokal në fshatin Ndroq, duke vënë baste sportive, me celularë. Në ambientet e lokalit u gjetën 5 celularë që përdreshin për lojëra fati dhe një shumë parash.

Gjatë kontrollit fizik, 34-vjeçarit iu gjet një sasi lënde e dyshuar narkotike kokainë, ndërsa gjatë kontrollit në banesën e 31-vjeçarit u gjet një armë sportive që e mbante pa leje.

Materialet iu referuan Prokurorisë, për veprime të metejshme.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent